

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE
QENDRA DERMATOLOGJIKE DHE ESTETIKE
“DAFA 02” SH.P.K

KAPITULL I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME


Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Ligjet nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, që rregullojnë marrëdhëniet tregtare dhe funksionimin e shoqërive, personat e poshtë shënuar:

- Kristaq Dafa**, atësia Niko, lindur në Memaliaj, Tepelenë më 10.06.1971 banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej leternjoftimit me nr. personal H10610118P.
- Artan Dafa**, atësia Trifon, lindur në Malëshovë, Përmet më 31.08.1964, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e leternjoftimit me nr. personal G40831045E.

Të cilët në cilësinë e Ortakëve Themelues, hartuan këtë Statut të Shoqërisë tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike “DAFA 02” shpk.

KREU I
OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK, AFATET

Shoqëria tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike “DAFA 02” shpk, nëpërmjet këtij Statuti, në përputhje me Aktin e Themelimit për krijimin e saj, bazuar në legjislacionin Shqiptar në fuqi, rregullon gjendjen juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e saj me të tretët, të dhënat me rëndësi për pozitën juridike të ortakëve në raport me shoqëritë dhe të tretët, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, organizimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë, si dhe çështje të tjera me rëndësi për mbarëvajtjen e Shoqërisë tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike “DAFA 02” shpk. Çdo çështje që nuk është shprehimisht e trajtuar në këtë Statut, do të interpretohet në përputhje me frymën e tij, nisur nga parimet e mirëbesimit, bashkëpunimit dhe interesit reciprok të ortakëve të shoqërisë.



Neni 1

OBJEKTI I SHOQËRISË

1.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

- Diagnostifikim i sëmundjeve të lëkurës
- Përdorimi i Dermatoskopit për kontrollin e nishaneve, diagnostifikimin e parakohshëm të kancerit të lëkurës.
- Trajtimi me medikamente dhe aparatura i fytyrës.
- Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë dhe çdo veprimitari që do të cilesohet nga Ortakët si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektivit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin shqiptar.

Neni 2

EMËRTIMI DHE SELIA JURIDIKE E SHOQËRISË

2.1 Emertimi i Shoqërise është Qendra Dermatologjike dhe Estetike “DAFA 02” shpk.

2.2 Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Rruga “Rreshit Collaku”, nr. pasurie 7/126+ - 45, volum 9.

2.3 Shoqëria mund të krijojë filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

2.4 Adresa e ortakëve në marredhëni me shoqërinë do të jetë ajo që rezulton e shënuar në librin e shoqërisë.

Neni 3

REGJIMI JURIDIK

3.1 Forma juridike e shoqërisë është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimitaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe legjislacionit ne fuqi. Ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e çdo mosmarrveshje eventuale që lind gjatë aktivitetit të shoqërisë është Ligji Shqiptar.

3.2 Kompetentë për zgiidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në paragrafin e mësipërm është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



3.3. Me vendim unanim, Ortakët mund të ndryshojnë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj.

3.4. Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

KOHËZGJATJA

4.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike "DAFA 02" shpk, është pa afat. Ortakët kanë të drejtë të kufizojnë këtë afat duke zbatuar procedurat për ndryshimin e Statutit.

KREU II

ORGANET DREJTUESE, MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË, EKSPERTËT

Neni 5

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të Shoqërisë tregtare Qendër Dermatologjike dhe estetike "DAFA 02" shpk.

janë:

- 1) Asambleja e ortakëve i cili është organi më i lartë vendimarrës.
- 2) Administratori i Shoqërisë, që caktohet nga Asambleja e ortakëve.

Neni 6

MARRJA E VENDIMEVE

6.1. Asambleja, rregullisht e thirrur dhe e përbërë prej ortakëve të shoqërisë, përfaqëson vullnetin e ortakëve. Vendimet e marra prej saj, për sa kohë, që janë të vlefshme në përputhje me ligjin dhe me këtë statut, detyrojnë të gjithë antarët e asamblesë edhe pse jo të pranishëm dhe jo dakort.



6.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë personalisht dhe disponon një numër votash të barabarta me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet në Asamble nga persona të tretë duke u lëshuaratyre prokurë të posaçme për çdo mbledhje të asamblesë.

6.3. Vendimet, në mungesë të prezencës së ortakëve, mund të merren pas konsultimit me shkrim të tyre, në rast se të gjithë ortakët miratojnë me shkrim përbajtjen e konsultimit. Në këtë rast zbatohen procedurat e përcaktuara nga ligji tregtar.

6.4. Ortakët lajmërohen për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë me shkresë apo me mesazh elektronik, i cili duhet të permbate vendin, datën, orvn e mbledhjes dhe rendin e ditës jo më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes.

6.5. Mbledhja e asamblesë mund të thirret nga Administratori i shoqërise, nga një ose disa prej ortakëve të shoqërisë që zoterojnë të paktën 5% të pjesëve të kapitalit themeltar.

6.6. Çdo mbledhje e asamblesë e thirrur në mënyrë të parregullt, mund të anullohet. Anullimi nuk ka vlerë, në rast se të gjithë ortakët janë të pranishëm ose të përfaqësuar.

6.7. Përsa kohë që, shoqëria “DAFA 02” shpk, do të ketë si organ vendimmarrës Asamblenë e Ortakëve, të drejtat dhe detyrimet do të ushtronen prej saj.

Neni 7

KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

7.1 Asambleja e ortakëve, përveç të tjerave, është i vetmi organ që vendos për:

- Emërimin ose shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve;
- Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, ekspertin kontabël dhe likujduesin;
- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e raporteve të administrimit dhe të kontrollit;
- Miratimin e llogarive vjetore, disponimin e fitimit, etj;
- Ndryshimet e statutit;
- Zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,

- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- Transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët;
- Zgjatjen e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo prishjen e saj dhe kalimin në proces likuidimi;
- Shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në forma të tjera; etj.

Neni 8

KUORUMI

8.1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm ose të përfaqësuar një ose disa ortakë që zoterojnë mbi 30% të pjesëve të kapitalit themeltar. Në rastet kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje si :

- Ndryshimin e Statutit,
- Zmadhimin ose Zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar,
- Shpërndarjen e fitimeve,
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se 50% të kapitalit janë të pranishëm.

8.2. Në qoftë se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet për mungesë kuorumi, thirret mbledhja e dytë brenda 30 ditëve me të njëjtin rend. Edhe në këtë rast vendime të vlefshme merren vetëm nëse është formalizuar kuorumi i nevojshëm në varësi të çështjes, rend dite.

8.3. Ndryshimet e statutit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të rregjistruar, shpërndarja e fitimeve riorganizimi apo prishja e shoqërisë dhe kalimi në proces likuidimi, shndërrimi në një formë tjeter, vendosen në mbledhjen e Asamblesë vetëm kur kuorumi i kërkuar përbëhet nga ortakët që zoterojnë më shumë se 1/2 e kapitalit themeltar dhe vendos me 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës.

8.4. Asambleja drejtohet nga një anëtar i zgjedhur nga ortakët e pranishëm. Të gjitha vendimet e Asamblesë transkriptohen dhe ruhen në rregjistrat eshoqërisë. Në rastet e përcaktuara me ligj, vendimet e asamblese duhet të rregjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

8.5. Dispozita të mësipërme në lidhje me mënyrën dhe kuorumin e kërkuar për marrjen e vendimeve, zbatohen në rast se shoqëria do të zoterohet nga më shumë se një Ortak.

Neni 9

ADMINISTRATORI

9.1. Ortakët, bien dakord që Administrator të shoqërisë tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike “DAFA 02” shpk të jetë **Kristaq Dafa**.

9.2. Afati i këtij mandati fillon me regjistrimin e këtij Statuti në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe vazhdon 5(pesë) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 10

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

10.1. Administratori drejton gjithë veprimtarinë e Shoqërise në pikpamjen tekniko-organizative, ka të gjitha kompetencat për të vendosur në lidhje me aktivitetin e zakonshëm dhe të përditshëm të shoqërisë. Administratori gëzon të drejta të plota në vendim-marrje dhe gëzon kompetenca të plota, përveç atyre që ky statut apo ligji injohin Asamblesë së Përgjithshme.

10.2. Të Drejta dhe Detyrimet e Administratorit të shoqërisë janë :

- Të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- Përfaqëson shoqérinë tregtare; kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisësë veprimtarisëdhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme;
- Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërise, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikavet tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për sa parashikon ky statut ose ligji.



Neni 11

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

Në rast se Asambleja e Përgjithshme e gjykon të arsyeshme ose nëse kërkohet në mënyrë të shprehur nga ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si dhe emërimi.

KREU III

MJETET E SHOQËRISË, KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 12

KAPITALI THEMELTAR

12.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike “DAFA 02” shpk, është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

12.2. Kontributet e ortakëve të shoqërisë në kapitalin themeltar janë si më poshtë vijon :

- **Kristaq Dafa**, 1 Kuote = 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit;
- **Artan Dafa**, 1 Kuote = 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit;

Neni 13

KUOTAT E KAPITALIT

13.1. Kuotat e kapitalit themeltar janë emërore dhe të transferueshme.

13.2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

13.3. Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen të tretëve vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë $\frac{3}{4}$ e pjesëve dhe kushte jo më të favorshme se atë me të cilat ju janë ofruar më parë ortakëve të tjerë duke respektuar të drejtën e parablerjes së ortakëve.

13.4. Sa mësipër, vetëm në rast se kuotat e shoqërisë zotërohen nga më shumë se një Ortak.



Neni 14

FONDET E SHOQËRISË

14.1. Shoqëria kryen veprimtarinë e saj me mjetet e investuara në fondet e saj dhe me mjetet të tjera. Ajo është e detyruar që vëllimin e punës së saj t'a ushtrojë në vartësi me shumën e mjetete të investuara në fondin themeltar të Shoqërisë dhe nga shuma e mjetete të rezervës.

Shoqëria përcakton fondet e mëposhtme :

1. Fondin themeltar
2. Fondin Rezervë

14.2. Për ushtrimin e veprimtarisë së saj Shoqëria mund të përcaktojë dhe fonde të tjera.

Neni 15

FONDI THEMELTAR

15.1 Fondi themeltar formohet nga mjetet e investuara nga ortakët dhe nga mjetet e tjera në para ose në formë tjetër të investuara.

15.2 Shoqëria shfrytëzon fondin themeltar për ushtrimin e veprimtarisë së saj, për investime në fondet e personave të tjera juridikë dhe fizikë si dhe për të përballuar rreziqet pas shfrytëzimit të mjetete të rezervës.

15.3. Gjithashtu mund t'i shfrytëzojë edhe për destinime të tjera sipas interesit të shoqërisë.

Neni 16

FONDI REZERVË

16.1. Fondi rezervë i shoqërisë formohet nga një pjesë e fitimit që Shoqëria realizon gjatë veprimtarisë së saj. Ai përcaktohet me një vendim të veçantë të Asamblesë së Ortakëve Themelues. Fondi rezervë mund të përdoret edhe për destinacione të tjera që janë në përputhje me interesat e shoqërisë.



KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE, DIVIDENTËT

Neni 17

VITI FINANCIAR

17.1. Cdo vit finansiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

17.2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e viti finansiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumicën e ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

17.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati të caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes së viti finansiar,

Neni 18

LLOGARITË FINANCIARE

18.1. Në fund të çdo viti kalendarik duhet të hartohej një bilanc si dhe një llogaritje e fitimeve dhe humbjeve. Me këtë duhet të ngarkohen ekspertë (këshilltarë taksash, revizorë etj). Fitimi i shoqërisë ndahet si më poshtë:

18.2. Sasia prej 5 % merren si rezervë ligjore në rezerva derisa janë arritur 20 % të kapitalit themeltar.

18.3. Shuma e mbetur ndahet midis ortakëve sipas pjesëve të tyre në shoqëri.

18.4. Forma e bilanceve dhe librave të llogarisë që do të mbajë shoqëria, përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 19

DIVIDENTËT

19.1. Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentëve. Fitimi, që do të ndahet midis ortakëve, në proporcione pjesët e kapitalit themeltar, përbëhet nga fitimi i viti finansiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë përfundin rezervë të domosdoshëm (5% e



fitimit të çdo viti deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

KREU V

KUFIZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 20

NDRYSHIMET E AFATIT

20.1. Kufizimi apo zgjatja e afatit të aktivitetit të shoqërisë mund të vendoset nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e ortakëve që zoterojnë mbi 3/4 e kapitalit themeltar.

Neni 21

PRISHJA E SHOQËRISË

21.1. Shoqëria prishet në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë statut, me vendim të Asamblesë së Ortakëve me kërkesën e 3/4 të pjesmarjes në kapitalin themeltar.

21.2. Shkaqet e prishjes së Shoqërisë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në Q.K.R;
- me Vendim Gjykatë;

Shoqëria nuk prishet kur njëri nga ortakët falimenton, bëhet i paaftë ose vdes.

NENI 22

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

22.1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një ose disa likuidues të cilët i paraqesin asaj/atij reportin mbi



giendjen e aktivit dhe të pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin, e domosdoshëm të përfundimit të tyre.

22.2. Në fund të procesit të likuidimit Asambleja me shumicën e ortakëve që zoterojnë mbi 3/4 e kapitalit themeltar vendos mbi bilancin përfundimtar finansiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe mbylljen e procesit të likuidimit.

22.3. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbeturë ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ata zoterojnë në kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.B për përfundimin e likuidimit dhe kërkon ç'rregjistrimin e Shoqërisë.

KREUVI

DISPOZITA-TË FUNDIT

Neni 23

SHNDËRRIMI I SHOQËRISË

23.1. Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionere mund të kryhet me miratim unanim të ortakëve që zoterojnë mbi 3/4 e kapitalit themeltar.

23.2. Marrdhëniet e brendshme ndërmjet punëtorëve dhe shoqërisë midis tyre dhe organeve të shoqërisë do të rregullohen me anën e një rregulloreje.

Neni 24

INTERPRETIMET STATUTORE

24.1. Pavlefshmëria e dispozitave të vecanta të kësaj marrvëshje nuk e prek tërësinë e saj vepruese. Në vend të dispozitave të pavlefshme ose për mbushjen e hapsirave statutore, ortakët bien dakord për një rregullim të përshtatshëm, në përputhje me qëllimin e hartimit të këtij statuti, duke ruajtur interesat e përbashkëta.

24.2. Për gjithshka jo të parashikuar në këtë statut do të respektohen normat ligjore të legjisacionit shqiptar në fuqi.

24.3. Gjykatë kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë periudhës së likuidimit ndërmjet ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



24.4. Ky Statut hartohet në 4 ekzemplarë origiinale, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë tregtare Qendra Dermatologjike dhe Estetike "DAFA 02" shpk.

Neni 25

DISPOZITA TË FUNDIT

25.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.


25.2. Për efekt të interpretimit të këtij Statuti, me ligj tregtar nënkuftohet ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

25.3 Pavlefshmëritë eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cënojnë vlefshmërinë në tërësi të tij.

ORTAKËT THEMELUES

TREJTARE QENDRA DERMATOLOGJIKE DHE ESTETIKE "DAFA 02" SH.P.K

KRISTINA DAFA



13.08.18